



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 113/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Arta Haxhaj kandidate për deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionerëve të Qendres së Numerimit të Rezultateve (QNR) për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Arta Haxhaj, kandidate për deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e subjektit politik AKR

Arsyetim

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Arta Haxhaj, në të cilën pretendohet se *“dyshon se në QNR i janë vjedhur votat pasi që në bazë të një dokumentacioni që posedon nga komunat ajo ka pasur 1415 vota kurse në atë të shpallur nga KQZ ka 1125”*.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtuesja e ankesës PZAP i beri një kërkesë KQZ-së me datë 31.01.2011, për sqarimin e pasqyrimin jo real të rezultateve përfundimtare, dhe KQZ iu përgjigj kësaj kërkesë për sqarim me datë 01.02.2011, duke njoftuar se “*procesin e votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditimit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Për shkak të mospërputhjeve të konstatuara numrit të fletëvotimeve mbi nivelin e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2011, 92 VV në zgjedhjet e 09 janarit 2011 dhe 38 VV në zgjedhjet e 23 janarit 2010. Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja te veçanta. Procesi i rinumërimit të votave në këto VV ka qenë transparent dhe është zhvilluar në praninë e vëguesve të subjekteve politike të certifikuara, medieve, faktorit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me këshilltarët e IFES-it. Mbi bazën e gjithë këtij procesi janë prodhuar rezultatet e QNR-së të shpallura nga KQZ me 30 janar 2011”.*

PZAP shqyrtoi Listat e VV të rinumëruara sipas vendimeve përkatëse të KQZ-së dhe Master Lista me QV për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 dhe erdhi në përfundim se parregullsite e pretenduara janë eliminuar gjatë rinumerimit dhe auditimit nga KQZ-ja. Si rrjedhim PZAP konstatoj se pretendimet e parashtuesit të ankesës janë korrigjuar dhe pere kete arsye e refuzoi ankesën si te pabazuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 113/2011 më datën 02.02.2011.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

